


KOQVARIA

Ballina: Yllka Zuzaku-Mustafa
& Xheneta Zuzaku



**YLLKA ZUZAKU-MUSTAFA
DHE XHENETA ZUZAKU,**
motrat që po shndërrohen
në histori suksesi në Zvicër



Gastric Bypass



DR. SHKODRAN KRASNIQI-
KIRURG VISCERAL DHE
METABOLIK

Pse Gastric Bypass?

- ✓ PËRMIRËSON OSE SHERON DIABETIN TIP.2
- ✓ RËNIEN E QËNDRUESHME NË PESHË
- ✓ PËRMIRËSON DUKSHËM TENSIONIN E LARTË
- ✓ DHE APNEN E GJUMIT



DR. FATMIR IMERAJ-
KIRURG VISCERAL DHE
METABOLIK

PËR INFO:

+383 48-184-200

+383 49-603-330



**Yllka Zuzaku-Mustafa
dhe Xheneta Zuzaku,
motrat që po shndërrohen
në histori suksesi në Zvicër**



Yllka dhe Xheneta janë motra. Të dyja jetojnë në Zvicër. Të dyja të suksesshme. Për sukseset e tyre lexoni në vazhdim...

YLLKA ZUZAKU-MUSTAFA MES ARTIT DHE SHËNDETËSISË ME DINJITET DHE SHPIRT

E lindur në Gjilan dhe e rritur në Zvicër, Yllka Zuzaku-Mustafa përfaqëson hijshëm gjeneratën e grave shqiptare që ndajnë jetën mes dy botëve, rrënjët në atdhe dhe horizontin në diasporë.

Me profesion infermiere dhe përvojë të gjatë në sistemin shëndetësor zviceran, ajo ka ndërtuar një profil të veçantë si profesioniste që i kushtohet kujdesit me dinjitet dhe shpirt.

Në qendër të punës së saj është "Spitex Diversity", organizatë që themeloi bashkë me motrën, për të ofruar kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës, me fokus në barazi dhe respekt për çdo individ.

Fusha e saj e specializimit përfshin geriatrinë, kujdesin paliativ dhe trajtimin e plagëve, duke u përkujdesur për ata që shpesh harrohen.



Përtej profesionit, Yllka është e lidhur ngushtë me artin dhe trashëgiminë kulturore shqiptare. Që më shumë se një dekadë drejton studion "Studio Aktrimi" në Cyrih, ku përmes teatrit dhe aktiviteteve kulturore ndihmon ruajtjen e gjuhës dhe identitetit shqiptar tek brezat e rinj. Me një karakter të qetë dhe një qasje të përgjithshme ndaj jetës, Yllka nuk ndjek protagonizmin, ajo frymëzon përmes përkushtimit të heshur dhe veprimeve me peshë. Nënë, profesioniste, artiste dhe aktiviste kulturore, ajo përfaqëson një shembull të fuqisë që vjen nga brenda dhe të dashurisë që shprehet në vepra, jo fjalë.

XHENETA ZUZAKU MES GRAVE SHQIPTARE TË SUKSESSHME NË ZVICËR QË PËRFAQËSOJNË NJË BREZ NDRYSHË

Historia e Xheneta Zuzakut është rrëfim i forcës, integritetit dhe përkushtimit.

E lindur dhe rritur në një ambient që nuk e favorizonte gjithmonë një emër me prejardhje të huaj, ajo dëshmoi se me vullnet të hekurt dhe punë të ndershme, çdo sfidë mund të tejkalohet. E rritur mes disiplinës dhe krijimtarisë, ajo gjeti shpirtin e saj të lirë përmes vallëzimit dhe artit.

Qysh si adoleshente shkroi tekste repi dhe incizoi këngë e videoklipe, duke

shprehur emocionet e saj të thella.

Vite me radhë kontribui edhe si ghostwriter për artistë shqiptarë, duke vënë në pah ndjeshmërinë dhe fuqinë e saj shprehëse.

Pasionin për artin e çoi edhe në skenën teatrore dhe në film, por rruga e saj profesionale mori drejtim në fushën e përkujdesjes shëndetësore.

Si infermiere e diplomuar, e specializuar edhe në andragogji dhe të drejtën e punës në shëndetësi, Xheneta është shembull i përkushtimit dhe strukturës në punë. Në vitin 2024, së bashku me motrën e saj, themeloi "Spitex Diversity", një model i ri përkujdesjeje që ndërthur cilësinë me respektin për diversitetin.

Për Xhenetën kujdesi për të tjerët nis me kujdesin për veten. Ajo beson thellë se vetëm një person që ushqen mirëqenien emocionale, mendore dhe fizike të vetes, mund të japë përkujdesje të vërtetë e të ndershme.

Roli i saj më i rëndësishëm është ai i nënës. Si nënë vetushqyese rrit vajzën e saj me dashuri, qartësi dhe dinjitet, duke e parë këtë si forcën e saj më të madhe, jo si pengesë.

Xheneta Zuzaku përfaqëson një brez të ri grash shqiptare në diasporë, të forta, të përkushtuara dhe të rrënjosura në vlera. Ajo udhëheq me zemër dhe vepron me mendje, duke mos harruar kurrë të kujdeset së pari për veten, sepse për të kujdesi është akt dashurie...

Nderim Neziri





200 vjet dhe ende gjallë!

Personazhi i këtij shkrimi është një realitet që më ndodhi ditë më parë, derisa pija kafënë e mëngjesit me shokë...

Para pak ditësh, derisa pija kafënë e mëngjesit me shokë, një i moshuar me plis në kokë, por i lodhur nga mosha e jeta, më ofrohet afër dhe më thotë se këtu në afërsi ndodhet një "gjykatë" e cila kryen shërbime pa pagesë.

Dhe, menjëherë mu kujtua se nuk është gjykatë, por shërbim juridik, i cili financohet nga shteti dhe shërben për këshilla juridike falas për hallexhinjtë.

I them:

"Vazhdo ecjen rreth shkollës "Elena Gjika",

pastaj përballë është një furrë buke e më pas një vetëshërbim i madh dhe jo larg tij ndodhet "gjykata".

"Qe sa herë po i bie poshtë e lart, por nuk po i bie në fije!", ma ktheu.

Dhe, pasi më falënderoi nisi të ecë në drejtim të "gjykatës".

Në çast ngrihem nga karrigia ku isha i ulur pranë shokëve dhe i them: "Burrë, prit pak! Të tregoj unë!".

Pasi ndalet më thotë: "Mos u mendo he burrë se ndoshta e gjej disi!".

Jo, i them, të tregoj unë që të mos bresh hësh poshtë e lart...

Dhe, teksa ecim pranë njëri-tjetrit, natyrisht e pyes nga ishte.

Më tha se ishte nga Busia e Prishtinës.

"Po, e di shumë mirë ku është Busia... Në fshatin tuaj jam strehuar 3 muaj me familje gjatë luftës, konkretisht në shtëpinë e mësuesit Nezir Gashit, i cili më ka pritur si të isha i familjes së tij!", i thashë.

"Eh, rahmetlia shkoi herët!", më thotë.

Dhe, para se të arrinim te "gjykata", si pa dashje, e pyeta: "Sa vjet i bane?".

Më thotë: "Me hjeke 200!".

E, kur u afrua te dera e "gjykatës", më tha: "A ma bën hallall për këtë zahmet që ta dhashë?".

"Hallall të koftë! Por, unë desha vetë të të ndihmoj", ia ktheva.

Ndërkohë, ai hyri brenda e unë u ktheva te shokët.

Pas një kohe, teksa bisedoja me shokë, diskutim më preku në krah. Kur ktheva kokën ishte ai, 200-vjetshi.

I thashë:

"A kreve punë?".

"Po", më tha.

"Shyqyr!", i thashë.

E, teksa largohesh, nga mosha dhe lodhja me vështirësi i ndërronte hapat...

"Eh, kjo është jeta!", e solla në mendje.

Isa ILAZI

CILA ËSHTË FYTYRA JONË, AJO E VËRTETA?



Bota është plot urrejtje dhe dhunë.

Nga ku lind përherë urrejtja e re dhe dhuna e re?

Gjithçka vlon nga garat për të arritur fuqinë, pushtetin dhe sundimin mbi të tjerët...

Bota ka plot ambicie, njerëzit sulen pas parasë dhe vrapojnë pas pasurisë.

Bota ka frikë nga njerëzit, e njeriu ka frikë nga njeriu.

Njerëzit kanë frikë nga sëmundjet.

Njerëzit kanë frikë nga vetmia...

Nuk dinë të jetojnë vetë me vetveten.

Nuk kanë rahatit të brendshme.

Janë të shqetësuar dhe të bren-gosur. Bredhin. Kanë frikë nga e panjohura.

Bota është e mbushur me luftëra për prestigj. Ka shumë egoizëm.

Ja, e tillë është jeta në të cilën jetojmë...

E, jeta jonë rrjedhë, ecë e shqetë-suar.

Përditë, përnatë, shkaku i takimit me të këqijtë, jemi të pakënaqur, me ankth, shpesh të lodhur, të rraskapitur, nervoz, të pashpresë.

E, ku të ikim nga të gjitha këto?

Në ndonjë ishull të qetë?

Po, edhe aty, mbase, do të shqetësojnë dallgët e dalldisura, të trazuara?!

Ku ta gjej vendin që t'më qetëso-het shpirti?

Ku gjendet ai vend?

*

Po të gjendeshe para mbretit, çfarë pamje do kishte fytyra jote?

Po të gjendeshe para lypësit, çfarë maske do shihej në fytyrën tënde?

Po të gjendeshe ulur para gruas e kur para të dashurës, cila pamje e fytyrës sate do të jetë e vërteta?

Pse, në secilën situatë, në secilën pozitë, në fytyrë kemi një maskë të veçantë?

Cila është fytyra jonë?

Cila është fytyra e vërtetë?

Pse maskohemi?

Pse fshihemi?

Gani DILI

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Artizanalet që po shuhen...

Ergyle Gjurgjialo

Plisa ka, burra s'ka!

Ergyle Gjurgjialo, nga Prizreni, është e vetmja grua që prodhon plisa në Prizren. Ajo që 40 vjet është munduar dhe mundohet ta ruajë traditën shqiptare.

Para një kohe, konkretisht në vitin 2017, në moshën 68-vjeçare në Gjakovë ka vdekur punuesi i njohur i plisave Sahit Mula, i cili veç punës së prodhimit të plisave ishte edhe aktivist i devotshëm për çështjen kombëtare, meqë para dhe gjatë luftës ishte në krye të këshillit për mbledhjen e Fondit të 3-përqindshit në komunën e Gjakovës, përkatësisht fondit për mbajtjen gjallë të arsimit në gjuhën shqipe. E, në Prizren ende është një grua e cila që 40 vjet merret me prodhimin e plisave. Ajo është Ergyle Gjurgjialo, edhe pse askush nga familja e saj nuk besoi se do t'ia dilte mbanë... Sidoqoftë, pavarësisht kundërshtimeve, Er-

gyle Gjurgjialo që 40 vjet vazhdon traditën njëshekullore të familjes së bashkëshortit në prodhimin e plisit. Ajo e ruan vazhdimësinë e punimit të plisit, simbol i identitetit kombëtar shqiptar.

PLISI ËSHTË PËRDORUR 2 MIJË VJET PARA ERËS SË RE

Sipas dokumenteve, arkivave që ruhen në muze të ndryshme të botës, plisi është përdorur ndoshta edhe 2 mijë vjet para erës së re.

Edhe Zeusi, që ishte zot i Olimp, paraqitet në fotografi dhe skulptura me plis në kokë.

Po ashtu, Akili, Hektori, Odiseu e edhe Afërdita paraqiten me plis në kokë.


Edhe për shqiptarët e kahershëm, përdorimi i plisit ka qenë rekuizitë e domosdoshme për çdo mashkull prej moshës rinore deri në shkuarjen nga kjo jetë. Punimi i plisit i është besuar gjithmonë duarve të burrave. Dhe, kështu ka ndodhur edhe në familjen Gjurgjialo në Prizren deri me nisjen e prodhimit të plisit nga gruaja Ergyle Gjurgjialo.

Dhe, falë Ergyles kjo zeje jo vetëm nuk u

zhduk, por arriti të bëhet e para grua që mori përsipër ta trashëgojë. Sipas familjes Gjurgjialo, prodhimi i plisit më shumë është pasion, meqë të ardhurat nuk janë të mjaftueshme. Por, ky fakt nuk e ka stepur familjen nga Prizreni, përkundrazi kanë investuar shumë që të mos cenohen nga konkurrenca e pandershme.



Sahit Mula



Pse të huajt dëshirojnë të varrosen në Kosovë?

Pak me pahi e pak përnjëmend, sa herë vjen Hansi në Kosovë e quajnë Hasan! Është i njohur në fshatin tonë të shpellës e më gjerë, sepse nuk po dua ta tregoj katundin, për të mos e bërë këtë shkrim artikull, meqë dua të dal diku tjetër, te Viliam Vokeri, ish-shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, që i dha Reçakut epitelin e fshatit që përjetoi gjenocidin e vërtetë nga Serbia.

Viliam Voker sivjet, më 15 janar, në përvjetorin e masakrës së Reçakut, ishte në mesin e shqiptarëve me plisa të bardhë. Ai, veç të tjerash, tha një gjë mbresëlënëse:

“Kur të kthehem vitin tjetër në Reçak, do të vij me një kuti të vogël dhe dëshira ime është t’me varrosin në Reçak, se këtu ndihem si në shtëpi!”

Prandaj, meqë thotë me gojë të vet se kur të vdes dua të më varrosni në Reçak, s’do mend se ai e thotë në formë amaneti, i cili edhe duhet përmbushur...

Por, këtë dëshirë nuk e ka vetëm Vokeri. Po këtë dëshirë e ka edhe gjermani Hans, që shqiptarët e Kosovës i thonë Hasan, dikush edhe Can. Ai tri herë në vit vjen në Kosovë në shoqëri me Shekun dhe familjen e Shekut.

Sivjet e takuam Hansin, demek Hasanin, te

ish-restoranti “Delfini”, unë dhe gruaja ime. Ai e flet goxha mirë shqipen dhe gruaja e ndezi muhabetin me të...

“Can, nuk po le dimër as verë pa ardhur në Kosovë! Pse je lidhur me Kosovën?”, i tha gruaja ime.

“S’mundem pa Kosovën, sepse është vend i bukur dhe me njerëz të mirë, sidomos për mysafirët. Edhe babai im dikur ka qenë në Kosovë, sepse ishte në Batalionin “SS”. Më ka folur për Kosovën dhe shqiptarët. Më ka treguar se nuk ka popull në botë si shqiptarët e Kosovës! E duan dhe e nderojnë të huajin, sidomos i nderojnë gjermanët”, ia ktheu gjermani dhe vazhdoi: “Unë kam qejf të varrosem në Kosovë. Kosova është vendi im dhe i babait tim! Në Gjermani s’të vjen kush te varri, kurse në Kosovë të vizitojnë edhe për së vdekuri...”

Hansi ka shprehur interesim të merr edhe

nënshtetësinë e Kosovës dhe të identifikohet me nënshtetësinë e shqiptarëve të Kosovës.

HANSI ME PLIS!

Hansi (Hasani) tashmë i di edhe festat tona kombëtare që lidhen me shtetin e Kosovës dhe i njeh edhe ditët festive religjioze në Kosovë.

Ai ka nisur edhe ta mësojë historinë tonë kombëtare.

Dhe, për datat historike vendos plisin në kokë dhe e identifikon veten me shqiptarët.

“Do t’isha i lumtur sikur t’isha shqiptar!”, thotë në fund të bisedës sonë Hansi dhe përshëndetet me ne me një shtrëngim duarsh.

S. M.

Kanadezi e afirmoi shqipen, ne e bastardojmë!

Ka vite e vite që e kam “bluar” në mend një vizitë Thethit, por arrita ta realizoja tek para pak ditësh, kohë kur isha 3-4 ditë në Velipojë.

Nga Velipoja, me tim bir, time bijë, dy mbesa e nipin, ia mësyjmë Shkodrës, pastaj marrim rrugën për në Koplik, rrugë e cila shtrihej rrëzë liqenit të Shkodrës dhe në periferi të Koplikut, në udhëkryqin për te Hani i Hotit marrim rrugën në të djathtë për në Theth. Nga ai udhëkryq e deri në Theth ishin 70 kilometra.

Në fillim rruga shkonte me një përpjetë të vogël derisa arrihet te restoranti “Buni i Bajraktarit”, e prej aty përpjeta nisë të jetë shumë e theksuar, aq sa kur arritëm në pikën më të lartë për në Theth, në vendin e quajtur “Qafë T’tshore”, lartësia mbidetare ishte mbi 1700 metra, kurse në afërsi të rrafshnaltës malet ishin të mbuluara me borë, pavarësisht se ishim kah mesi i muajit maj.

Në atë lartësi piktorekse shtrihen vargmalet e Alpeve Shqiptare dhe jo pak njerëz ndalen të bëjnë pak pushim, fotografohen dhe pastaj marrin teposhtën për në Theth, rrugë e ngushtë e me kthesa të mëdha (vende-vende edhe 180 shkallë),



Autori i shkrimit
në Theth



Pllaka e varrit të albanologut Robert Elsie

për të zbritur në Theth në 700 metra lartësi mbidetare. Dhe, pas dy orë e gjysmë vozitje nga Shkodra, kur arritëm në Theth, disi sikur u çlirua nga ajo ngarkesë e rrugës me kthesa të mëdha dhe deshe a s'deshe ndalesh në restorantin e parë për t'u freskuar me një kafe. Gjatë qëndrimit në kafene s'ke si të mos i vështrosh malet që e rrethonin ultësirën e Thethit, por, ndërkohë, zhgënjehesh me ndërtimet e shumta të kafeneve e restoranteve, si dhe të vilave vend e pa vend që e kishin shëmtuar bukurinë e magjisë së quajtur Theth dhe ky ishte zhgënjimi im i dytë në Shqipëri, meqë kam prituri ta shoh Thethin e dokumentarëve të shumtë me natyrë të virgjër e jo me bagerët që bënin zhurmë kudo. E, zhgënjimi i parë ishte në vitin 1990, kur edhe shkela për herë të parë në Shqipërinë e shkatërruar, që e kisha menduar me fusha të gjëra me lule e lisa të gjatë të Naimit. Dhe, pasi pimë kafe dhe bëmë një pushim nja një orë, nisëm të ecnim nëpër Theth. Vizitorë sa të duash, kryesisht të huaj, por edhe punëtorë që punonin, madje edhe bagerë të shumtë që bënin zhurmë të madhe. E, kah mesi i Thethit ndodhej kisha me pamje të mirë, në tabelën e së cilës shkruante se ishte rindërtuar

dhe financuar para disa vjetësh nga një shqiptaro-amerikan i cili jeton në Amerikë. Kisha e Thethit daton nga viti 1892. Famullitari i parë ishte At' Shtjefën Gjeçovi, i cili në vitin 1917 po në këtë vend hapi edhe shkollën shqipe, duke qenë edhe mësues i fëmijëve, traditë që e ndoqën edhe priftërinjtë e tjerë të kësaj kishe. Ndërkaq, jashtë oborrit të kishës, rrethuar me grila, ishin varrezat e Thethit, në fillim të të cilave ndodhej varri i albanologut të njohur kanadez, Robert Elsie, i lindur në Vankover të Kanadasë në vitin 1950, kurse vdes në Berlin të Gjermanisë më 2017, e që nga Berlioni, sipas amanetit të tij, e varrosin në Theth, vend në të cilin edhe kishte kaluar një pjesë të jetës së tij gjatë gjurmimeve albanologjike të

kësaj treve të veçantë shqiptare. Dhe, pasi i biem trup e tërthor Thethit, s'ka si të mos ndalemi për një pushim paksa më të gjatë në njërin nga restorantet e shumë për një drekë me ushqime vendore. E, pasdite, teksa e lëshoj Thethin, nuk më largohej dot nga mendja se sa udhëtim i këndshëm do ishte po të marrja rrugë nga Thethi për në Valbonë, rrugë e cila bëhet vetëm në këmbë shkaku i terrenit të thepisur malor. Mirëpo, ajo rrugë 12 kilometra nëpër malet e thepitura të alpeve shqiptare mund të kalohet për nja 8 orë ecje...

Isa ILAZI



Marigona Hill:
049 162 000

info@marigonahill.com
www.marigonahill.com



MARIGONA[®]
SUN



Marigona Sun:
048 226 111

belong@marigonasun.com
www.marigonasun.com

Burgu e pleqëria janë vetëm për shqiptarë!

Njerëzit dinë të bëhen nervozë edhe kur nuk i çon gjykatësi në burg, sepse skamja të çon edhe në derë të hasmit!

Si popull jemi të çuditshëm: krekosemi vend e pa vend!

Shtrohet pyetja: Pse jemi të tillë?

Por, përgjigjen nuk e di...

Dal në shitore dhe blej një birrë të gjermanit "Beks", sepse e kam parë në reklamë.

Shitësi nuk i ka dhjetë centë për t'mi kthyer. I them: "S'ka gjë! Pak punë kryhen me dhjetë centë! Askush s'ka bërë shtëpi me dhjetë centë!".

Shitësi e pohon me kokë atë që them unë dhe i vjen mirë.

Pas meje një i huaj bleu grejpfrut dhe e pret kusurin me cent. Shitësi mendon si me shqiptarë se nuk paraqesin problem disa centë. Por, i huaji nuk largohet nga arka pa ia kthyer edhe centin e fundit...

Sidoqoftë, i huaji, para se të largohet, tha: "Kur e fiton vetë e kursen, e kur ta jep tjetri e harxhon lehtë!".

Dhe, në çast, mu kujtuan fjalët e gjakovarëve - bëjmë pazar nëse e ke mall të babës!

E, pasi doli i huaji dola edhe unë.

Në derë takova Nezirin, që sapo kishte

ardhur nga Zvicra.

Por, desha a s'desha nuk më lëshoi pa makiato...

Hymë në kafenenë e parë dhe gjetëm vend në një qosh të lokalit. Pak më larg nesh dy djem të rinj, rreth 18 vjeç, bisedonin në telefon me vajzat që ishin me to...

Ngrihet Neziri dhe njërit ia jep shpullë!

"O Nezë, a je çmendur?!", i bërtas.

"Janë nipat e mi, po harxhojnë pa nevojë!", ma ktheu ai.

BURGU E PLEQËRIA VETËM PËR SHQIPTARË!

Kishte kohë që nuk kisha dal në qytezën e vendlindjes.

Dhe, papritmas takoj një shok të shkollës - tashmë gjykatës, i cili pasi më përqafoi më tha të pimë nga një kafe.

Edhe si nxënës ka qenë i mirë dhe i tillë ka mbetur akoma.

E pyeta për punën e tij.

Më tha: "Më së shumti jam në hall me vullnetarët që kërkojnë të shkojnë në burg!"

Dhe, mbeta i befusuar...

Pas pak i thashë: "Kush është çmendur të shkojë në burg vullnetarisht?!".

Teksa bisedojmë, futet në lokal një burrë rreth të gjashtëdhjetave me vetëm një dhëmb në gojë.

E, posa afrohet afër nesh i drejtohet tim shoku:

"Jam filani... Para pak ditësh më ke dënuar me 100 euro gjobë se më ka zënë roja e pyllit me qerren mbushur dru. Por, s'kam para ta paguaj dënimin, andaj të kërkoja në zyre që ato 100 euro t'mi shndërrosh në burg menjëherë sa s'ka dalë vera se pastaj kam punë në ara".

Dhe, në çast më vijnë mendimet se sa e çuditshme është jeta në Kosovë: Njeriu kërkon të shkojë në burg dhe as në burg nuk e çojnë!

Pastaj, m'u kujtuan fjalët e një miku që ndodhet në Gjermani: "Pleqëria nuk është për shqiptarë!"

Me demek, s'ke para të blesh dru, të blesh bukë, të blesh barëra, të blesh...

S. Murturi



Me ata që s'duan të jenë të njohur...

Më mirë kamerier se deputet i dirigjuar nga partia!

Kam menduar se në Kosovë të gjithë dëshirojnë ta kenë statusin e të njohurit, por, në fakt, kjo nuk qenka edhe e vërtetë, sepse paska ende njerëz që e duan jetën e qetë dhe këtë e dëshmuar edhe të anketuarit tanë...

Si duket, shumëkujt të qenit i famshëm e nervozon. Dhe, edhe pse një gjë e tillë duket e pabesueshme në këtë kohë kur shumëkush mundohet të bëhet emër, hasëm edhe në të anketuar që ishin kundër.

Ata me të cilët biseduam thanë se sot gjithkush po bëhet deputet, politikan, këngëtar, moderator...

Tash për tash shumëkush po arrin të bëjë famë me të dalë disa herë në televizion apo në portalet tona, e që askush nuk e di se sa është numri i tyre, sepse janë bërë shumë.

A ËSHTË FAMA GJITHÇKA?

Tashmë disa nga të njohurit tanë janë neveritur nga emri, njohja, publikimi, edhe pse ende kanë mbetur të atillë që bëjnë çmos të ekspozohen!

Të vjen keq që aktorët tanë, të cilët në pamundësi që të realizojnë projekte të reja, më shumë rrinë në kafene sesa në teatër...

Çka u nevojitet fama?

Madje, shumë prej tyre, në bisedat që i patëm, thonë se janë penduar që i kanë hyrë kësaj rruge...

Të vjen keq si këngëtarët vrapojnë pas organizatorëve për t'ua marrë paratë e premtuara. E, të mos flasim për manipulimet që bëhen me ta...

Ndërkaq, kur flasim për moderatorët, shumica prej tyre më shumë përkujdesen se si të duken bukur, sesa të flasin a të lexojnë mirë e pa gabime!

E, ç'mendojnë ata që nuk janë të famshëm?

EDON JETULLAHU, PRONAR BUTIKU: PËR MUA KËNGËTARËT NUK JANË BASH ASKUSH!

- Unë tërë jetën e kaloj duke vrapuar se si ta furnizoj butikun tim me mallra që janë në hap me kohën, pra sa në Ferizaj e sa në Stamboll, e as që kam kohë të merrem me familje, e lëre më të përcjell debatet televizive të politikanëve tanë apo deklaratat pa fije kripe të këngëtarëve e këngëtareve tona se si nuk kanë kohë as për gjumë, ndërkaq tërë kohën e kalojnë nëpër kafene e diskoteka t'u u sorollatë!

Pra, nuk më duket interesante jeta e këngëtarëve, edhe pse nuk jam kompetent të jap vlerësime, sepse shumica prej tyre s'kanë haber me këngën!

Sidoqoftë, jeta e tyre është me shumë telashe. Martohen për interes dhe pas një kohe ndahen. Jeta e tyre është valë-valë, si në filma...

Andaj, jam i kënaqur me punën që bëj, edhe pse nuk kam shumë para, por jam i ndershëm. E, kjo për mua ka rëndësi, sepse parandë ftoj me djersë, e jo siç bëjnë shumica me dallavere...

VERANDA HAJDINI, MËSUESE: MË PËLQEN TË JETOJ E QETË DHE PA PROBLEME

- Jeta e artistëve dhe e politikanëve në Kosovë nuk më pëlqen fare. Te ne ka pak prej

atyre që, vërtet, meritojnë të quhen artistë. Tashmë të gjithë e dinë se si shkon puna të bëhesh artist, meqë sot në Kosovë gjithkush mund të bëhet figurë e njohur publike!

Ai a ajo që ka pak para dhe ka ndonjë të njohur, bën emër menjëherë!

E, unë fle qetë dhe bëj punën time, pa e munduar kokën, sepse nuk e lejoj askënd të merret me mua dhe të bëjë thashetheme...

DOLAN GASHI, KAMERIER: S'DUA TË JEM DEPUTET A POLITIKAN I DIRIGJUAR!

- Po bëhen 5 vjet që punoj kamerier dhe që nga fillimi më ka pëlqyer kjo punë, ani pse e kam kryer fakultetin juridik.

Asnjëherë s'kam menduar të kyçem në ndonjë parti politike dhe të bëhem figurë publike, sepse nuk më pëlqen jeta e deputetëve a politikanëve që dirigjohen nga partia e tij, siç është rasti i tashmë me zgjedhjen e kryeparlamentares së Kuvendit të Kosovës, e cila ka mbetur peng i një njeriu, e që me teket e tij të sëmura e ka bllokuar jetën politike në Kosovë!

PËR FUND

Shumica e të anketuarve tanë nuk e lakmojnë jetën që bëjnë këngëtarët, deputetët a politikanët tjerë në Kosovë, meqë, siç thonë ata, janë të dirigjuar nga partia së cilës i takojnë...

Diturie Haxhaj

“Prej se pi raki jam bërë poet!”



*Puna e shoferëve dhe e poetëve është bërë si “boza e Haxhi Agës”,
thonë në vendlindjen time... Pse?*

Na e porositi kolegja nga një pije, në shenjë të qerasjes që e kishte marrë patentë-shoferin.

Dhe, m’u kujtua gruaja ime kur doli në provim për ta ngarë veturën. U ofrova të shihja nëse dinte ta drejtonte veturën “Opel Corsa 1.3” të Ministrisë.

Kur u nis m’u duk sikur u nis me shpejtësinë e katërt! U nis si anija kur tundet në valët e detit!

Me t’u kthyer me komisionin në vendin ku edhe kishte startuar, ia zgjatën dorën. I thanë: “Urime, ke kaluar!”.

U ofrova afër komisionit dhe u thashë: “Nuk keni bërë mirë që e kaluat se e merr veten në qafë!”.

“Kështu e dashke gruan ti, a?!”, më tha njëri prej tyre.

“E dua shumë, andaj nuk dua ta thyej kokën!”, ia ktheva.

NËSE DONI T’U PËRZË KAMERIERI NGA LOKALI BËHUNI POET!

Dikur janë shitur shumë librat me poezi.

Në vitet 70-80 ishte një revolucion në Kosovë sa i përket poezisë, bashkë me këngët patriotike.

Kemi duartrokatur për secilin poet (palaço) kur kanë lexuar ndonjë varg patriotik!

Ua kemi vënë flakën shalleve në sallat e sporteve kur dëgjnim këngët për Mic Sokolin, Bajram Currin, Azem Galicën...

Ndërkaq, në orët e dikurshme letrare, ku shtrohej darkë e raki pas leximit të vjershave, në njëfarë mënyre nënkuptohej se poet i madh ishte ai që pinte shumë raki dhe e jetonte jetën i

dehur!

Dhe, kjo mendësi ende jeton te disa poetë.

Një i tillë, i ditëve tona, u fliste dy vajzave të reja se si hidhen vargjet në letër...

“S’paskam për t’u bërë kurrë poete, andaj po e lë këtë profesion që tash!”, i tha njëra-tjetrës.

E, meqë nuk qëndrova indiferent ndaj asaj që dëgjova, u thashë:

“Vajza, sot për t’u bërë poet është shumë lehtë. Poetët, zakonisht, janë njerëz të dështuar në jetë, prandaj si të tillë pinë raki, duke qëndruar në lokale derisa t’i përzë kamerieri! E, ju, nëse doni t’u përzë kamerieri nga lokali, bëhuni poetë!”.

Dhe, fill pas fjalëve të mia, duke qeshur me të madhe, dolën nga lokali...

S. Krivaça



Në Spitalin Anaderm, ofrojmë trajtim të specializuar për sëmundjet e venave dhe arterieve duke përdorur dy metoda të avancuara:

Trajtimi me lazer – Ky trajtim minimalisht invaziv është i përshtatshëm për rastet që e lejojnë dhe realizohet shpejt, nuk ka nevojë për hospitalizim. Pacientët rikthehen shpejt në aktivitetet e përditshme.

Trajtimi manual – Përdoret për ato raste ku trajtimi me lazer nuk është i mundur. Kjo metodë ka dhënë rezultate të shkëlqyera në trajtimin e venave dhe arterieve, duke siguruar shërim të plotë për pacientët.

Jam 10 vjet më e vjetër se i dashuri, por e dua!

Jam grua që jetoj jashtë Kosovës. Kam ardhur në pushim në Kosovë, por jam shumë e brengosur për personin me të cilin duhem. Nuk po mund të largohem prej tij, edhe pse jam më e vjetër se ai dhjetë vjet. E dua përjetësisht, por nuk di si të martohem me të?

"Francezja"

Je nënë, e ndarë nga burri.

*E do personin për të cilin bën fjalë,
por ai është i huaji, sepse është i
martuar.*

*Lidhjen tënde e di shumëkush, sepse
jeni të dy familjarë dhe nuk mund të
zgjat lidhja juaj shumë.*

*Fëmijët tu janë të rritur. Andaj, është
e pamundur të vazhdoni përjetë-
sisht një lidhje pa marrë parasysh që
duheni.*

*Mirë është t'u kthehesh fëmijëve
tuaj dhe energjinë e dashurisë t'ia
kushtosh familjes tënde...*

*Besojmë se me kohë do ta kuptosh
këshillën tonë qëllimshme...*



VENDI KU FILLOJNË
KU JTIMET MË TË BUKURA.

KOMPLEKSI ELIZA PARK A

SUHAREKË

+383 44 106 777
www.cimaks.com

Një jetë në libër



Ditë më parë doli nga shtypi libri voluminoz i Adem Shalës “Gjurmë të një jete” (autobiografi).

Vargut të librave shqip, që temë trajtimi kanë shkollën shqipe, këto ditë iu shtua edhe libri “Gjurmë të një jete” i Adem Shalës, kurse biblioteka shqipe pasurohet me një libër në të cilin prezantohen përpjekjet e autorit për të mbajtur gjallë arsimin shqip në kohët më të vështira në Kosovë, por edhe nismën dhe zgjerimin e tij në Gjermani ku tash jeton e vepron. Pa hyrë në hollësi, autori ngjarjet i paraqet në mënyrë kronologjike, ashtu si kanë ndodhur në të vërtetë, me të gjitha rezultatet, e edhe me vështirësitë, e që herë-herë janë të mëdha, por jo edhe të pakapërcyeshme, ani pse rropatet me përditshmërinë në punë, në jetë. Nis me trungun e të parëve të vet të ardhur nga Toplica. Në hollësi dhe me fakte tregon për shpërnguljen me dhunë nga trojet e tyre, rrugëtimin e gjatë e të mundimshëm e me shumë të papritura derisa arrijnë në Drenicë, vend të cilin e konsideronin me më

shumë siguri, si dhe përpjekjet e tyre për të nisur jetën e re. Mirëpo, familja e tij rehatohen tek kur vijnë në Sllatinë të Madhe të Fushë-Kosovës ku ndodhen edhe tash. Babai tij, Hamdiu, adhures i shkollës shqipe, arrin që edhe në kushtet e vështira t’i shkollojë të gjithë fëmijët, gjë që për kohën ishte shumë e rëndësishme. Kështu, Ademi arrin të bëhet profesor, më vonë drejtor shkolle, e më pastaj të jetë në ekipin për formimin e Mbrojtjes Popullore të Kosovës me kërkesën e Presidentit të atëhershëm Dr. Ibrahim Rugovës, punë të cilën e kreu disa vjet, derisa regjimi i kohës u bie në gjurmë dhe nisë me burgosjet e anëtarëve, me ç’rast Ademi arrin të ikë dhe furtunat e jetës e përlajnë sa në Bullgari, sa në Shqipëri, sa në Gjermani. E, në Gjermani, pas shumë peripecive, i shtrinë rrënjët thellë dhe me përkushtim të madh hapë shkollën e parë shqipe në qytetin Viersen, qytet

ku jeton dhe punon edhe tash. Në librin e tij autobiografik autori arrin që nëpërmjet jetës së vet të paraqes edhe jetën e popullit shqiptar të Kosovës nëpër periudha të ndryshme historike, por edhe aktivitetet e tij në diasporë. Shkurt, libri i Ademit është i mbushur me fakte për secilën periudhë kohore, me dëshmi dhe përjetime të autorit kudo ku ndodhet ai... Dhe, gjithmonë në kërkim të dijes, në përpjekje për t’u ngjitur shkallëve sa më lart në kala, mu në kulmin e karrierës autorin e këtij libri e shohim në takime me personalitete të larta të kohës – Dr. Ibrahim Rugovën, Ismail Kadarenë, Ibrahim Kadriun, Hamza Halabakun dhe me veprimtarë të shumtë. Sidoqoftë, libri autobiografik “Gjurmë të një jete” është libër me mesazh të qartë se kur njeriu ka një synim të caktuar, sado që të ketë vështirësi në jetë, cakun e arrin herë do kur.

Isa ILAZI



Diçka në shpirt po më kall **e çka nuk e di!**

Ti nuk je ajo që unë e doja! Të doja nga foto-grafitë e dikurshme. Të rrinin mirë të gjithë fustanet me buzëqeshjet e fytyrës! Tani ti je një tjetër, që shprehë frikë në fytyrë, kurse ajo që unë e doja ka vdekur përgjithmonë...

I tillë, si jam sot, isha qëkur i mbaj mend lulet dhe fluturat. Gjeja forcë të vrapoja pas tyre derisa i fusja në dorë. Lulet nuk mund të iknin, por fluturat kishin fuqi më të madhe se unë. Aq sa vrapoja për ta provuar fuqinë me fluturat, babai më thoshte mos mendo se janë vetëm dy krahë të lehtë, sepse aty është fuqia fluturuese. Kur u rrita sa jam tash, isha ulur në një stom dheu dhe i shikoja lulet nëse kishin fluturë. Babai më tha se unë sërish kisha mbetur fëmijë, si kisha qenë dikur! Më tha se tash dalloj vetëm për nga gjatësia e trupit! U dëshpërova shumë kur ma dha babai

atë vlerësim dhe shpejt u ktheva në odë. Vura kokën mbi jastëkun prej kallëpi të kashtës së fortë, në kërkim të pushimit të mesditës. Desha t'ia merrja inati babait, por mu hodh në kokë si një shkëmb i rëndë tregimi i tij se si ishte rritur jetim dhe thashë se babai nuk e kishte jetuar rininë me prindërit dhe nuk dinte deri në cilën masë mund ta lëndojë fëmijën sikur bëri me mua...

Andaj, edhe e fala, sepse s'kisha çfarë tjetër t'i bëja! Ai edhe ashtu dukej i lodhur nga jeta e jo nga mosha. E vendosa kokën në jastëk dhe për pak minuta ndjeva lagështinë në jastëkun prej kallëpi. Shi nuk binte, mendova në atë përgjumje.

Ah, më ranë lotët... E pashë veten tek vrapoja një vërrie gurishte të mbushur lule dhe barë. E mbaja për dore dikë që nuk e kisha sot dhe, madje, më erdhi në mendje edhe emri i saj.

Pse t'ia merrja inati babait, kur unë, vërtet, nuk isha rritur?! Sepse, ky që jam sot isha edhe para dhjetëra vitesh!

Atë që e kisha ëndërruar me kokë mbi jastëkun e kallëpit, e shihja ëndërr, por nuk di se kush ishte... Nuk di as pse qaja! Por, gjithnjë më dukej se isha penguar t'i përjetoja fluturat dhe lulet si dikur... Deudi i vogël, trevjeçar, doli më rezonues se unë kur i thashë se e kisha djalë babanë e tij...

E, ai mu përgjigj:

"Jo, ti nuk ke si ta kesh djalë, sepse ai nuk është i vogël!"

Kishte të drejtë Deudi, sepse mund ta kesh fëmijë dikë vetëm sa është i vogël!

Andaj, ula kokën në jastëk dhe serish e ndjeva lagështinë e jastëkut.

Unë po qaja, sepse isha rritur në botën time të luleve dhe fluturave dhe doja të je-toja ende si fëmijë, vetëm brenda saj. Por, sa herë që ngritja kokën, e shihja babanë duke më ndenjtur mbi kokë dhe duke më thënë se je rritur e më nuk je fëmijë, e, në fakt, unë shikoja me bisht të syrit nëse babai më shikonte dhe me t'u larguar sado pak, unë me sjellje bëhesha fëmijë si edhe kisha qenë dikur.

Sepse, më pëlqente të isha fëmijë...

Unë nuk kisha dashur as të rritesha, apo ndoshta kisha pranuar të isha pak më shumë se fëmijë...

Ti më beson, por ti nuk je këtu pranë meje sonte... Edhe ti je pak si fëmijë.

Ndjej si mund ta kallësh botën për një flutur!

Ndjej si mund të vdesësh për një dashuri!

Ndjej se më thua ikim në qiell mbi ndonjë re që ka shi!

Dhe, me kokën mbi jastëkun prej kallëpi dua të të them se ka ardhur pranvera ime, ka sjell lule dhe ka çka të të dhurojë çdo ditë...

B. Bajrami

Hamshori për një natë!

“Ishte ditë e rëndomtë. U takova me të në “Qafë”, në Prishtinë. Na pëlqeu muhabeti dhe shpejt u gjetëm në shtrat në banesën time. “Çfarë fatlumi jam!”, e solla në mendje, në atë moment.

“Të nesërmen, kur u zgjova, ajo nuk ishte në shtratin tim. Mbi tavolinë kishte lënë porosinë: “Mos më kërkol!”, thotë Merimani, teksa kujton femrën shumë më të moshuar se ai, e që mendoi se gjithmonë do të jetë me të. Dhe, e tëra që përjetoi Merimani, student i anglishtes në Prishtinë, në natën ndërmjet

një e dy prillit të sivjetmë, mund të rumbullakohet me një fjali të vetme: Hamshor për një natë! Ai, faktikisht, ra viktimë e epsheve, të mos themi është shfrytëzuar prej saj, së cilës në fillim ia mësoi vetëm emrin shkurtës – Dita.

Ky rast, të cilin vetëm e mora si pretekst për këtë shkrim, nuk do të ishte edhe aq interesant sikur të ishte i vetmi. Në këtë rast, mashkulli shpërblehet me kënaqësi për shërbim që i bën femrës, e femra e gjen prenë e vet, ndonjëherë edhe duke paguar “viktimën”.

E, si realizohet diç e tillë?

Thjesht, zonja (mund të mos jetë edhe e tillë) ka nevojë për shfryrje epsesh edhe me dikë, pos me burrin, por frikësohet se do ta kuptojë rrethi. Nga shoqja e vet, si në shaka, kupton se një gjë e tillë edhe mund të realizohet.

Por, që të realizohet një gjë e tillë duhet të dilet jashtë banesës, në ndonjë lokal, të njihesh me një person dhe pas njohjes duhet bindur atë që të ruajë sekretin.

Pastaj, sa herë ke mundësi shkon në banesën e tij dhe kalon çastet e dëshiruar...

Por, rasti i Merimanit nuk përmbyllët vetëm me një natë. Ajo pas pak ditësh kthehet po në të njëjtin lokal dhe e gjen sërish Merimanin dhe pas ndejës përfundon sërish në shtratin e tij. Dhe, jo vetëm një natë e dy, por me muaj të tërë, aq sa edhe dashurohet marrëzisht në të.

Dashuria e saj për Merimanin tash s’kishte fund, kështu që edhe ndahet nga burri, vetëm e vetëm që të ishte me dashnorin, jo që të martohej me të, sepse ajo e dinte se ai nuk do të martohej me një femër që ishte e martuar, por që të kalonte sa më shumë çaste bashkë me të.

Por, pas një viti ata u thyen keq ndërmjet veti dhe Merimani e braktisi njëherë e përgjithmonë.

E, kush e ka radhën të shkurorëzohet nga burri që të jetë në krahët e Merimanit do e tregojë koha...

Diturie Haxhaj

BEHU GATI PER VERE

OFERTË

3 MUAJ -20%

6 MUAJ -20%

1 VIT -30%

📍 Aktash
📍 Bregu i Diellit


POWER
HOUSE

Një tragjedi që shkatërroi një familje...

Eminja është personazh i familjes nga Ferizaj, e cila në vitin 1999 kishte emigruar në Zelandë të Re. Babai saj shkoi atje që të largohej sa më larg nga vatra e luftës, por edhe me bindjen se do të gjente tokën e premtuar e pas qëndrimit disavjeçar do të kthehej në vendlindje dhe me vete do i merrte gruan dhe fëmijët.

Por, ç'ndodhi që u rrënua gjithçka?

Në vitet e para kësaj familje në Zelandë të Re puna i shkonte mirë. Mërziteshin se në Kosovë kishin lënë familjarët tjerë, por kur mendonin se atje ishin përkohësisht e tejkalonin mërzinë...

Por, pas disa vjet qëndrimi atje ndodhi një kthesë që as në ëndërr nuk e kishin parë. Babai i Eminës, i cili ishte duke punuar në një kontingjent ndërtimi si shofer, teksa kthehet nga puna në shtëpi pëson aksident trafiku dhe pas ca ditësh vdes në spital.

E, kjo fatkeqësi u reflektua rëndë në familjen pesëanëtarësh. Fëmijët u tronditën shumë, kurse e ëma pëson krizë nervore.

Eminja ishte fëmija më i madh në familje, por nuk ishte në gjendje edhe ta mbante familjen.

E, meqë shteti ku jetonte i kishte rregullat e veta, për familjet si kjo nisi t'u jepte ndihma sociale dhe në këtë aspekt nuk u hetua shumë mungesa e mjeteve materiale, përveç dhembjes së madhe që kishin për babanë e ndjerë dhe nënën që rehabilitohej nëpër qendra rehabilitimi.

NË SPITALIN E TË ÇMENDURVE GJETI NËNËN!

Tragjedia e familjes ferizajase ishte shndërruar në një dramë të vërtetë. Eminja ishte shumë këmbëngulëse se do e gjente nënën e saj, kudo qoftë ajo...

Kishte vizituar edhe institucione që merreshin me rehabilitimin e njerëzve, aq sa një ditë gjendet edhe në një spital

rehabilitimi në një vend të lartë malor, në një spital psikiatrik.

Dhe, deshi fati e mu aty ishte nëna e saj, e që posa e pa nga larg në oborrin e spitalit vrapo dhe iu hodh në përfaqim së ëmës. Mirëpo, e ëma, nga terapia që i kishin dhënë që të qetësohej, ishte shumë e ftohtë ndaj së bijës, madje as që pyeti për fëmijët tjerë...

Andaj, e thyer shpirtërisht largohet prej së ëmës me lot në sy, por me shpresë se një ditë e ëma do shërohej dhe do u kthehej lumturia në familje.

Por, edhe pse e ëma e Eminës i kaloi disa vjet në spital, ende ndodhet në rehabilitim dhe një Zot e di a do të shërohet që ta lëshojnë nga spitali e t'i bashkohet familjes...

Shkëlqim Guri

Të kallin lotët që i ke në brendi!

Ajo vinte drejt meje me fytyrë të zbehtë. Kishte qëndruar tërë natën pa gjumë. I ishte mbushur mendja se ishte bërë e tepërt në shtëpinë e saj, tek jetonte në kohët tona, e që po e quajmë kohë moderne.

E kishin bindur në shtëpi se ishte bërë e tepërt, edhe pse aty është lindur, rritur e shkolluar.

“Është bërë boll në shtëpi! Më duhet të ik dikah, ta gjej fatin!”, më thotë ajo. Në pamje duket sikur ecë duke i bërë vetes 1001 pyetje, e që fillojnë nga pyetjet enigmatike me pse... Pse u linda? Pse u rrita?

Pse punoj?

Pse jetoj?

Dhe, shumë pse si të Spasses sonë të madh.

Shoh një lum lotësh brenda saj. Por, ajo s'ka guxim të qajë në rrugë. E ka maskuar fytyrën, por unë shoh se te ajo, si te oda e gjermadhës, nga brenda del çdo gjë.

Flet pamja, flet depresioni...

Sa shumë mund ta gjej veten njeriu, them me vete. Sheh një vajzë të bukur dhe mendon se çdo gjë brenda saj është po aq e bukur, sikur duket nga jashtë. Mund të preket, madje, edhe nga ngacmimet e rrethit të saj, që e marrin për një bukuroshe të ndërtuar e të mbushur lumturi!

Në fakt, nuk e dinë se brenda saj jeton një femër krejt tjetër, e cila, realisht, mendon se shtëpia duhet t'u mbetet të tjerëve dhe se ajo, vërtet, duhet ta braktisë shtëpinë me çdo kusht, sepse

aty më nuk e ka vendin dhe se është bërë e tepërt.

Dhe, e gjeti apo nuk e gjeti fatin, ajo duhet të del si bleta kur lëshon...

Më mbetet në kokë pamja e saj, tek ndaj bindjen se si mund të ketë, në shekullin XXI, ende sjellje të tillë ndaj fëmijës.

Më mbetet në kokë pamja e saj me lotët e brendshëm, tek e ka bindur veten se shtëpia e saj më nuk është e saj!

Nuk është i saj as oborri, të cilin e ka pastruar me mijëra herë.

Nuk është e saj as dhoma e vet, as shtrati ku fle!

Pra, nuk janë të saj shkakut i një burri që do ta ketë, deshi apo jo. Sepse, nëse s'do e gjejë vetë, do ia gjejnë familja me çdo kusht, edhe pse ajo është akademike.

Keq, a?

S.

MARINA BAY
2025 SEASON

MANY CHOICES
1 LEGEND



MANY CHOICES
1 LEGEND

FOR INFO & RESERVATION
+355 69 604 1000 | info@marinabay.al

A portrait of Dr. Naim Azemaj, a middle-aged man with a bald head and a light beard, wearing black-rimmed glasses and a white lab coat over a blue checkered shirt. He has his arms crossed and is smiling slightly. A black pen is in his left breast pocket, and a wristwatch is on his left wrist. The background is a bright window with sheer curtains.

BOOM

Dr. Naim Azemaj,
shqiptari që po
i ndryshon standardet
e mjekësisë në Zvicër



Dr. Naim Azemaj, shqiptari që po i ndryshon standardet e mjekësisë në Zvicër

Në një kohë kur teknologjia dhe mjekësia po zhvillohen me ritme marramendëse, e ardhmja e kujdesit shëndetësor qëndron te personalizimi, humanizmi dhe parandalimi. Pikërisht këto janë shtyllat mbi të cilat Dr. Naim Azemaj, mjek shqiptar nga Kosova me bazë në Zvicër, ka ndër-tuar jo vetëm karrierën e tij, por edhe një nga klinikat më moderne dhe të veçanta në rajon.

Nga hulumtimet për melanomën në Vjenë, deri te themelimi i "Clinic Finemed" në Oftringen, rrugëtimi i tij është një histori frymëzimi, sakrifice dhe vizioni. Revista jonë, "Kosovarja", sjell për lexuesit këtë rrëfim ekskluziv me Dr. Azemajn, ku ndalet në momentet kyçe të formimit profesional, sfidat e emigracionit, përqafimin e qasjes holistike dhe dashurinë për jetën përtej laboratorëve dhe klinikës.

Dr. Azemaj, ju vini nga Kosova dhe jeni emër i njohur në Zvicër. Si do ta përshkruani rrugëtimin tuaj nga fillimi deri te krijimi i një klinike moderne në zemër të Evropës?

- Pas përfundimit të gjimnazit në Prishtinë, në vitin 1990 emigrova në Zvicër ku jetonin prindërit dhe familja ime. Studimet universitare i përfundova në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Vjenës, në Austri. Gjatë dy viteve të studimeve atje, u angazhova në kërkime shkencore në Departamentin e Dermatologjisë, me fokus te melanomat-tumoret e lëkurës. Pas diplomimit u riktheva në Zvicër dhe fillova punën në Spitalin Universitar të Cyrihut (USZ), fillimisht në Klinikën e Kirurgjisë Torakale, e më pas në Kardio-kirurgji, Radiologji dhe Mjekësi Interne. Krahas punës vazhdova edhe hulumtimet shkencore në fushat përkatëse, duke kontribuar në zhvillimin e metodave të reja diagnostikuese (CT dhe MRI) për detektimin sa më të saktë të rajoneve potencialisht ishemike në muskujt e zemrës. Rezultatet janë të publikuara në PubMed. Pas specializimit në Mjekësi të Brendshme dhe të Përgjithshme, si dhe një eksperience intensive në Klinikën e Urgjencës në USZ, u emërova shef i Departamentit të Urgjencës në Spitalin Linth, ku isha edhe anëtar i Bordit Drejtues.

Që nga viti 2019 drejtoj ordinancën time private "Arztpraxis Oftringen", në Kantonin Aargau dhe i ofroj të gjitha shërbimet mjekësore të një ordinance

internistike moderne.

Në vitin 2024 përfundova subspecializimet në Mjekësinë Preventive Anti-Aging, Regenerative dhe Estetike, përmes European College of Aesthetic Medicine. Po ashtu, u specializova në "Performance Diagnostics", ushqyerjen në sport dhe analizën HRV në Deutsche Sporthochschule Köln.

Qëllimi im ka qenë gjithmonë ofrimi i një mjekësie të personalizuar dhe precize për çdo individ, duke nisur nga analizat laboratorike, analizat epigjenetike e gjenetike, e deri te diagnostikat radiologjike dhe performance diagnostics të avancuara.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha gjatë shkollimit dhe specializimeve tuaja në një vend të huaj?

- Sfidat më të mëdha ka qenë të mbetëm i fokusuar dhe i disiplinuar në një ambient me pritshmëri të larta.

Për të arritur aty ku jam sot, është dashur të punoj më shumë se kolegët e mi vendas.

Sakrificat më të mëdha ishin jeta private - familja më ka parë shumë pak, meqë pjesën më të madhe të kohës e kaloja në punë, shpesh deri në orët e vona të natës.

Keni një përvojë të gjerë në disa degë të mjekësisë. Si arritët ta ndërtoni këtë larmi?

- Fillimisht doja të specializoja në dermatologji, por e kuptova shpejt se kishte shumë më tepër për të mësuar. Andaj vendosa të kaloja nëpër disa fusha për

të pasuruar përvojën dhe njohuritë e mia. Kam pasur fatin të kem mentorë të jashtëzakonshëm, konkretisht Profesorin Walter Weder, drejtor i Spitalit të Cyrihut, i cili besoi në potencialin tim. Përvoja në të gjitha klinikat ka qenë shumë e vlefshme dhe kam ndërtuar një rrjet profesional të fuqishëm në Zvicër.

Si lindi ideja për "Clinic Finemed"?

- Gjatë karrierës gjithnjë më është shtuar dëshira për të krijuar një mjedis ku pacientit t'i ofrohet më shumë kohë dhe vëmendje, me fokus në mjekësinë preventive, regenerative, anti-aging dhe estetike. Shoqëria moderne kërkon jo vetëm trajtim të sëmundjes, por edhe strategji për mirëqenie afatgjatë, performancë fizike dhe jetë me cilësi më të lartë.

Çfarë e dallon "Clinic Finemed" nga klinikat tjera në Zvicër dhe rajon?

- Ne jemi unikë në Zvicërën gjermanofolëse për shkak të qasjes së personalizuar në diagnostikë dhe trajtim. Ofrimi i analizave laboratorike, epigjenetike, gjenetike dhe të gjitha formave të diagnostikës moderne është baza jonë. Në fushën e mjekësisë estetike dhe dermatologjisë çdo trajtim është ekskluziv dhe i përshatur për secilin individ.

Na tregoni më shumë për qasjen tuaj holistike. Çfarë nënkupton ajo në praktikë?

- Qasja holistike është thelbësore. Diagnostikimi i hershëm i defekteve ose deficiteve në sistemet organike na mundëson të ndërhyjmë në kohë për të parandaluar ndryshimet irreversible. Ne analizojmë të gjitha aspektet e shëndetit të një pacienti dhe më pas krijojmë një plan të personalizuar për ruajtjen e shëndetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Cilat janë shërbimet kryesore të klinikës suaj dhe kujt i drejtohen?

- Klinika jonë nuk fokusohet në trajtimin e sëmundjeve, por në parandalimin, regjenerimin, anti-plakjen dhe mjekësinë estetike. Shërbimet tona përfshijnë:

- Analiza laboratorike të plota,

- vitamina, hormone, aminoacide, tumor markerë
- Menaxhimin e metabolizmit dhe peshës
- Analiza epigjenetike dhe gjenetike
- Diagnostikë me imazheri të avancuar: CT, Heart CT, Body MR
- Performance diagnostics "State of the Art"
- HRV
- Mjekësi estetike jo-invasive, përfshirë laser medicine

A besoni se mjekësia moderne po i afrohet më shumë shpirtit të pacientit? Si arrini të ruani humanizmin në një profesion kaq të teknologjizuar?

- Teknologjia ka sjellë njohuri të reja të jashtëzakonshme për proceset intracelulare dhe për rolin e geneve dhe epigjenetikës. Por, humanizmi mbetet thelbësor. Ai ruhet përmes edukimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit të modestisë.

Teknologjia nuk mund të zëvendësojë asnjëherë kontaktin njerëzor dhe përkujdesjen shpirtërore që një mjek duhet të ofrojë.

Si arrini të ruani ekuilibrin ndërmjet jetës profesionale dhe asaj personale në Zvicër?

- Me sport të përditshëm, triathlon, jogging dhe not. Balanca është thelbësore, si dhe koha cilësore me familjen dhe shoqërinë. Vetmia është një faktor rreziku numër një për vdekshmëri në pleqëri.


A keni ndonjë zakon apo rutinë që ju mban energjik dhe të përqendruar?

- Long-distance jogging dhe cycling janë të pazëvendësueshme për stabilitetin emocional dhe mendor. Arritjet profesionale më mbushin shpirtërisht, por tani është koha të ndaj përvojën time edhe me shoqërinë.

Dhe, për fund, çfarë u sjell më shumë lumturi jashtë profesionit?

- Pa asnjë dyshim, vajza ime, Mira Noemi. Udhëtimet me të, çdo moment i kaluar me të m'i jep ngjyrat më të bukura që mund të përfitoj në jetë. Gjithashtu, kalimi i kohës me familjen, shoqërinë dhe sporti janë burimet e mia të lumturisë.

Nderim Neziri



Artistët tanë që nuk lanë gjurmë në politikë

Janë të afirmuar. E quajnë veten artistë. Por, në politikë nuk u treguan edhe aq të suksesshëm! Kush janë ata?



LABINOT TAHIRI (LABI)

Labinot Tahiri ka filluar të këndojë që në moshë të re, duke i përcjellë hapat e babait të tij. Ishte vështirë të këndohej në kohën kur këndonte Labi, sepse shtëpia e kulturës ishte e mbyllur për shqiptarët dhe koncertet mbaheshin në mënyrë "ilegale" nën regjimin e atëhershëm. Megjithatë, aktiviteti i tij prej këngëtarri rritej çdo ditë e më shumë. Ka performuar brenda dhe jashtë vendit. Dëshira e tij e flakët ishte të këndonte me këngëtarë të mëdhenj, konkretisht me Ismet Pejën, dëshirë e cila u realizua kur Labi këndoi me Ismet dhe Visar Pejën së bashku në programin e Vitit të Ri 2007, në të ashtuquajturën "Sofra kosovare". Kënga ishte shumë e pëlqyer nga publiku dhe ende dëgjohej me ëndje.

Por, edhe Labi, si Sabriu dikur, i hyri politikës dhe në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 ishte në listën e koalicionit LDK-AKR dhe siguroi 15.540 vota, të cilat ia mundësuan vendin e deputetit.

Por, në zgjedhjet pasuese nuk arriti të fitojë vendin e deputetit, andaj mbet jashtë listë së atyre që fituan dhe e braktisi politikën.



SABRI FEJZULLAHU

Sabri Fejzullahu i takon gjeneratës së vjetër të këngëtarëve, i cili ka arritur që edhe në kohën e re të zë vendin e vet në muzikën argëtuese të Kosovës, por edhe më gjerë.

Ka fituar 18 "Okarina të Arta" në "Akordet e Kosovës", ka incizuar më se 800 këngë, ka marrë pjesë në shumë festivale dhe ka fituar shpërblime, brenda dhe jashtë vendit.

Ka bashkëpunuar gjithmonë me kompozitorët më të mirë të vendit.

Pra, një këngëtar i talentuar.

E, edhe si aktor ishte i mrekullueshëm.

Por, lakmia që ta provojë skenën politike ia zbehu meritat. Gjatë periudhës 2001-2004 ishte deputet në Parlamentin e Kosovës nga radhët e PDK-së.

E, a i është dëgjuar ndonjëherë zëri në Parlament, këtë e di gjithsecili?!



ADRIANA MATOSHI

Adriana Matoshi njihet si njëra ndër aktoret më të suksesshme të kinematografisë së Kosovës, e që numëron edhe shumë çmime nga festivale prestigjioze.

Dhe, përpos që është e njohur në kinematografi, është e njohur edhe për rolet e shumta në teatër dhe seriale.

Mirëpo, edhe Adriana Matoshi i hyri politikës dhe në vitin 2021 arriti të grumbullojë 10.403 vota dhe fitoi vendin e deputetes nga radhët e VV-së.

Por, edhe në zgjedhjet e vitit të sivjetmë fitoi vendin e deputetes nga e njëjta parti, por tash për së dyti herë si deputete.

Megjithatë, shtrohet pyetja: Sa herë e kemi dëgjuar të flasë a diskutojë në Kuvend?

Sidoqoftë, ka edhe artistë e këngëtarë të tjerë që janë munduar të bëhen pjesë e politikës, por pa sukses...

Sinan Vllasaliu: Atë që ia dua vetes ia dua popullit tim!

Ditë më parë në njërin nga televizionet tona ishte i pazëvendësueshmi Sinan Vllasaliu, i cili teksa fliste për jetën e tij, tha: "Atë që ia dua vetes ia dua popullit tim!"

E, shkas për këta rreshta është mu kjo fjali, që të jep të kuptosh shumë, sepse njeriu vetvetes ia dëshiron të gjitha të mirat, e në këtë rast edhe popullit të cilit i takon.

Dhe, jo vetëm kjo fjali ishte për çdo lëndatë, por edhe përgjigja në pyetjen: "A e urren kënd?" ishte me shumë logjikë.

"Nuk e urrej askënd, por kur njeriu thotë "Ata hajvana" - çka ke me fol për të!"

"Me kë do doje të pije kafe me këta që janë gjallë?", ishte një nga pyetjet.

"Me të mëhallës sime", tha.

"E, me ata që nuk janë gjallë?", ishte pyetje tjetër.

"Me Fadil Vokrrin", ishte përgjigja e tij shkurt.

Sidoqoftë, Sinan Vllasaliu ka karrierë të bujshme në muzikë, me hite e duete që nuk i ka asnjë nga këngëtarët tanë deri më tash...



Pse tradhtojmë?



Tradhtia konsiderohet shkatërruese për një marrëdhënie dhe zakonisht çon në ndarje. Edhe nëse pas kësaj nuk vjen fundi i lidhjes, raportet ndryshojnë dhe marrëdhënia merr kah të ri... Ç'thonë të anketuarat tona?

SHEMJA:

KAM TRADHTUAR, SEPSE KISHA NEVOJË PËR KËNAQËSI!

Shemja është 55 vjeçe, doktoreshë. Ka ordinancë të veten. Deri në lidhjen e saj të mëparshme, ajo nuk e kishte tradhtuar kurrë partnerin.

"Marrëdhënia ime me burrë nuk ishte edhe aq e mirë, andaj më mungonte kënaqësia e plotë. Dhe, në mungesë të kënaqësisë së plotë nisa marrëdhënien e fshehtë me një pacient timin, e që pas një kohe jam ndarë nga ai, e vetëdijshme se nëse vazhdoj tutje mund ta shkatërroj martesën time", tha Shemja, nga Mitrovica, punëtore shumëvjeçare në profesionin e saj.

ERMIRA:

TRADHTOVA PËR T'U HAKMARRË!

Ermira ka hyrë në të 40-at. Është e martuar që 11 vjet. Burri i saj, biznesmen i njohur nga Shkupi, më shumë e kalon kohën nëpër udhëtime zyrtare sesa në shtëpi. Ermira kishte kohë që ishte në dijeni se bashkëshorti i saj e merrte sekretaren e tij në udhëtime zyrtare dhe sa herë i thoshte burrit se e di një gjë të tillë, ai i qetë e mohonte.

"Tradhtia ime ndaj burrit ka ndodhur para tre vjetësh, por mendoj se kam mashtruar për t'u hakmarrë!", tha Ermira, 41 vjeçe, me shpresë se detajet tjera nuk do i publikojmë.

KIMETJA:

KAM TRADHTUAR PËR TË PROVUAR SE Ç'NDJENJË ËSHTË!

Kimetja, 33-vjeçare, farmacistë nga Prishtina, e martuar qëkur ishte 19 vjeçe, ende dëshiron të duket e vëmendshme para meshkujve në lokale, rrugë e gjetiu. Ajo ende dëshiron të ndihet sikur ua tërheqë mendjen meshkujve.

"Më pëlqen të ndihem e dëshiruar, përkundër faktit se kam jetë të mirë martesore, edhe pse burri im, si duket, nuk ma di vlerën!

"Burri me të cilin e tradhtova tim burrë ishte gjinekolog dhe çdo gjë nisi në ordinancën ku kontrollohesha...", thotë Kimetja, e cila nuk dëshiron të shpallosë më shumë detaje.

SARANDA, NGA PEJA: TRADHTIA ËSHTË BËRË PJESË E JETËS SIME!

"Burrin e parë e kam pasur të mrekullueshëm. Kalonim mirë, derisa erdhi në jetën time inkasanti i rrymës dhe ma prishi rehatinë. S'di as vetë si m'i mori mendtë dhe iu dorëzova.

Por, tradhtia ime nuk zgjati shumë, meqë im burrë ishte në dijeni se nuk rrija rehat, andaj edhe më la dhe u dha pas një tjetre...

Tash jam me burrin e dytë, por edhe me këtë nuk pres të jem tërë jetën, meqë

ka kohë që po më vardiset një student i njërit nga fakultetet në Pejë dhe jam ndërmjet dy hamendjeve: T'ia nis a të mos ia nis?!", thotë Saranda, e cila ndihet në faj pse ka vepruar dhe po vepron në këtë mënyrë.

SEMJA, KLINË:

"TRADHTOVA PËR TË GJETUR MARRËDHËNIE MË TË MIRË!"

"Nëpërmjet "Facebook"-ut kërkoja kontakte, kështu që e tradhtova lidhjen time. Unë dhe partneri im ishim bashkë me vite dhe kishim ëndrra për martesë, fëmijë dhe jetë së bashku.

Por, faza e eksitimit na kishte kaluar prej kohësh dhe rutina na lodhte deri në kohën kur një pronar butiku më tërhoqi vëmendjen dhe më bëri të ndihem sërisht e gjallë, andaj shkova në shtrat me të. U ndjeva sikur çdo gjë piku nga qielli!", tha klinasja Seme, 32 vjeçe.

PËR FUND

Sipas ekspertëve, dimri është periudhë ku shumica e njerëzve futen në lidhje, si mënyrë për ta larguar mërzinë dhe depresionin që sjell sezoni.

Psikologët tregojnë se zvogëlimi i pranisë së rrezeve të diellit gjatë muajve të dimrit është shkaktar i formimit të lidhjeve të reja, kurse prania e diellit (motit të nxehtë) gjatë pranverës ka të bëjë me ndarjet.

Diturie Haxhaj

Revolucion në
DOBËSIM
Worldwide franchise



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë.
Rrugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë.
Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm.
Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përmbushur ëndrrat e tyre.



MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Kush më mbrojti në aksidentin që pata?

Zonjë, të shkruaj nga shtrati. Kam pasur aksident të rëndë. Kam qenë në shpejtësi të madhe, por shqyr Zotit kam mbetur gjallë.

Kam dhënë shumë herë sadaka. Në familje më kanë thënë se sadakaja më ka shpëtuar.

A është e vërtetë?

“E aksidentuara”

Përgjigje:

Bartja e gjërave të ndryshme është përforcim i vetëbesimit te njeriu. Vetëbesimi është një mekanizëm shpirtëror që përforcon mendjen dhe shpirtin, imunitetin dhe luhatshmërinë, me të cilat miliona njerëz në botë sot kanë probleme dhe kërkojnë shërim në klinikat neurologjike shkaku i stresit, fobieve dhe frikave të ndryshme...

E, sa i përket sadaksë është mirë që keni dhënë.

Ka edhe njerëz që bartin me vete gjëra të besimit si mbrojtje nga rreziqet aksidentale apo edhe kundër keqbërjeve

dhe magjive të zeza.

Më së shumti njerëz që bartin me vete gjëra të besimit ka në Turqi dhe në Indonezi, por duke mos e përjashtuar as Evropën e Amerikën.

Askush nuk është imun ndaj magjive dhe askush nuk është i pandjeshëm ndaj streseve dhe depresioneve aq më shumë që sot jetojmë në shekullin që psikoanalistët e quajnë “shekulli i stresit depresiv”.

Në Turqi shpesh ndodhin tërmete dhe gjatë procesit sizmik rritet shumë numri i njerëzve që bartin hajmali, në mënyrë që t'i shpëtojnë më të keqes.

Andaj, besimi, sadakaja dhe gjërat e besimit llogariten me peshë të madhe pozitive.

Në Teksas ekziston një objekt i tillë mbrojtës që vendoset në gjoks dhe gjatë përleshjeve që ndodhnin realisht, kishte fakte se ata që e kishin bartur atë mbrojtje, në momentin e caktuar, plumbi kishte goditur pikërisht metalin, e që e kishte shpëtuar njeriun nga vdekja. Kështu, edhe në rastin tuaj nuk

po e përjashtoj këtë mundësi, megjithëse besimi është një fushë e gjerë ku secila fjalë ka peshën e vet të vlerësimit.

Fati i vonuar

Zonjë, jam 43-vjeçare. Kam diplomuar para shumë vjetësh. Kam punuar gjashtë vjet, por më larguan nga puna për arsye se nuk bëhesha kukull e shefave.

Megjithatë, kam mbetur pa e zgjidhur fatin e jetës...

Deri para dy vjetësh e kam pritur një person me të cilin doja të lidhja jetën, por plani im dështoi.

Mirëpo, meqë koha ime ka ikur sa i përket fatit, të lutem, çka më pret në jetë dhe a do kem fat të kem edhe unë njeriun tim apo jo?

“Pa shifër”

Përgjigje:

E ke pritur njeriun që ishte martuar kaheerë, andaj edhe ishte gabimi yt jetik, sepse i ke humbur 13 vjet për atë person. E shkuara, megjithatë, nuk kthehet.

Por, çka tash?

Nga parashikimi im për ty del se dy oferta do t'i kesh brenda gjashtë muajve dhe e dyta do të jetë më e përshtatshme për ty. Shpresoj shumë që do të jetë fati yt. Mos e refuzo!

A do t'më kthehet burri?

Jam grua, jetoj jashtë Kosovës. Kam probleme me burrë. Herë pas herë është i mirë dhe i afërt me mua, por

kohëve të fundit më është larguar shumë dhe po e shoh se ai po shmanget prej meje. Kam përshtypjen se problemet tona janë brenda shtëpisë sonë, por nuk di si ta gjej formulën e vërtetë për ta pasur burrin për vete. Çka të bëj dhe çka është në pyetje që ai po largohet? A do të jem me të apo do të vijmë ditë më të vështira për mua dhe fëmijët e mi?

“Era vdekje”

Përgjigje:

Kur jeni njoftuar me burrin e di se kush nuk të ka dashur në atë shtëpi. Keni pasur luftë të madhe derisa jeni bërë bashkë, sepse burri të ka dashur, por nëna dhe babai i tij dhe një motër nuk të kanë dashur kur-rë, por gjërat disi kanë pushuar në mënyrën që ka funksionuar bashkëshortësia juaj dhe tash janë rikthyer te ata orekset e vjetra kundër teje. Kjo do të thotë se nuk të duan ata që nuk të donin edhe dikur... Në dhomën tënde, në rrobat tua, do të gjesh plumb të shkrirë dhe flokë. Largoje nga shtëpia dhe besoj se gjërat do të ndryshojnë për të mirë...

A do të arrin djali t'ua heq krizën?

Jam një zonjë, jetoj në Maqedoni. Jam shpesh në depresion, nuk e di të ardhmen time... Dua të më tregosh çka më pret në të ardhmen, sepse

jam në mundime shpirtërore dhe a do t'më heq djali nga kriza?

“Tetovarja”

Përgjigje:

Shoh se je ndarë nga burri dhe djalin e ke rritur te familja jote. Por, ndër vite është bërë një mëkat i madh ndaj djalit, sepse është nëpërkëmbur nga familja jote. Ai do të arrijë të krijojë pasuri, por nuk do ta harrojë sjelljen e keqe të familjes tënde. Pas një kohe shoh se do të kalosh në banesën tënde me djalë dhe më nuk do jesh e varur nga familja e vajzërisë...

Babai nuk po pajtohet, a ka magji?

Jam vajzë, 37-vjeçare, jetoj në Zvicër. Kam probleme me babanë, meqë nuk po pajtohet me fejesën time, sepse nuk i pëlqen i fejuari im... Derisa nuk kisha të dashur më thoshte çka po pret, e prej se kam bërë të dashur nuk dëshiron ta shoh me sy! Mami im po thotë se ka magji. A është e mundshme?

“E pikëlluara”

Përgjigje:

Mosha jote i dikton gjërat dhe lëvizjet. Deshe a nuk deshe ka qenë një moment vendimtar që të bësh fejesë me këtë person, edhe pse ka qenë i martuar. Fëmijën e tij e ka nëna e vet dhe unë shoh se mund të përshtateni në jetën tuaj.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Te ata nuk ka ecur martesë si duhet, prandaj kudo që nuk funksionon diçka duhet t'i vjen fund.

Unë shoh se babai ka magji dhe ato mund t'i gjeni në dy vende ku ai fle: në shtëpinë në Maqedoni dhe në banesën ku jetoni.

Kontrolloni rrobat e tij në orman dhe do t'i gjeni disa sende të dyshimta. Hidhni jashtë shtëpisë dhe ai do të qetësohet.

Nuk po më bën zgjidhje, çka të bëj?

Jam nga Vitia, 27-vjeçare, kam një hall.

E dua një djalë dhe besoj se edhe ai më do, por nuk po më bën zgjidhje.

Jemi bashkë qe katër vjet.

Para një kohe e hapëm këtë temë. I thashë se nuk mund të dalim më se jam duke

biseduar në internet me një

djalë tjetër. Më tha: “Si po ma

bën këtë kur e di se të dua!”

Por, kur i thashë pse nuk po

fejohemi, më tha – ka kohë

edhe për këtë punë...

Çka të bëj?

“M. 27”

Përgjigje:

Mos e prit. Kërkoje fatin tënd dhe tërhiq prej tij, sepse nuk do të fejojesh me të!



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



@dentfix ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC